

## A mund të votoj ?


Portali për zgjedhjet  
komunale dhe provinciale  
të 13 tetorit 2024

Një pyetje

Numri jeshil : 1718 (numër pa pagesë)  
Email : [elections@spw.wallonie.be](mailto:elections@spw.wallonie.be)  
Façe interneti : <http://electionslocales.wallonie.be>

## Si bëhet ?

Kontakttoni qendrën rajonale  
në territorin tuaj



Ose DISCRI



Realizimi :  
DisCRI Asbl, CRIPEL

Redaktor përgjegjës :  
Farid Nagui, Place Gustave Falmagne 5  
5000 Namur


**Komuna ime,  
unë jetoj atje, votoj atje !**

Ti je një person i huaj  
që plotëson kushtet  
për të drejtën e votës ?  
Regjistrohu si zgjedhës  
(e) dhe bëje zërin tënd  
të dëgjohet gjatë  
zgjedhjeve komunale !



Me mbështetjen e





Ajo është e destinuar për të gjithë shtetasit e Bashkimit Evropian (BE), si dhe për të gjithë shtetasit jashtë BE-së që kanë banuar në Belgjikë për të paktën 5 vite në mënyrë të pandërprerë në kohën e kërkesës së tyre për regjistrim.

## Të shkosh në votim: një veprim qytetar

Çdo person që jeton në Belgjikë banon në territorin e një komune.  
Pushteti komunal është më afër qytetarëve dhe qytetareve.



**Votimi do të thotë të shprehësh vullnetin tënd për menaxhimin e komunës suaj.**



Të gjithë personat e huaj që regjistrohen në regjistrin e zgjedhësve, kanë edhe detyrimin për të votuar, përveç rastit kur kanë mungesë të justifikuar ose prokurë.

## Kush mund të votojë në zgjedhjet komunale ?

### Çdo person belg :

- ▶ T'i ketë mbushur 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve ;
- ▶ Të gëzojë të drejtat e tij civile dhe politike ;
- ▶ Të jetë me vendbanim në një komunë ;

### Çdo person i huaj :

- ▶ Një shtetas jashtë Bashkimit Evropian, i cili vë në dukje, në momentin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim, pesë vite të pandërprera qëndrimi kryesor në Belgjikë, të mbuluar nga një qëndrim ligjor ;
- ▶ Shtetas jo-belg i Bashkimit evropian i regjistruar jo më vonë se 31 korrik 2024.

Personat që u regjistruan për zgjedhjet e mëparshme komunale nuk duhet të regjistrohen përsëri, por i nënshtrohen detyrimit për të votuar.

## Unë regjistrohem

### Si ?

Duke paraqitur një kërkesë për regjistrim. Përveç kësaj, shtetasit jashtë BE-së duhet të nënshkruajnë një deklaratë\* me të cilën angazhohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet e popullit belg dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Formulari i regjistrimit është i disponueshëm në shërbimin e popullsisë në administratën tuaj komunale dhe në Qendrën Rajonale për Integrimin e personave të huaj ose me origjinë të huaj (CRI) pranë vendbanimit tuaj.

### Ku dorëzohen dokumentet ?

Në shërbimin e popullsisë në administratën tuaj komunale.

Nëse dëshironi, ju mund të dorëzoni kërkesën tuaj për regjistrim dhe deklaratën tuaj në komunën tuaj përmes një shoqate.



Është e rëndësishme që të regjistroheni jo më vonë se 31 korrik 2024. Me këtë regjistrim, regjistroheni automatikisht për zgjedhjet e ardhshme komunale dhe më pas jeni të detyruar të votoni.

*Si një person i huaj jo-evropian, aktualisht nuk keni të drejtë të paraqiteni si kandidat ose candidate në lista. Nga ana tjetër, evropianët/et mund të vendosen në listat zgjedhore për zgjedhjet komunale dhe të zgjidhen si këshilltarë/këshilltare apo edhe përfaqësues i komunës/përfaqësuese e komunës apo kryetar/kryetare të CPAS-it.*